




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT PËR VITIN 2022

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut (KMI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- C1 Pasuritë kapitale që janë në menaxhim të komunës (tokat, parcelat, lokalet, dhe objektet të ndryshme afariste, objekte shkollore, shëndetësore, sportive dhe kulturore), Komuna nuk i ka regjistruar në SIMFK të cilat rrjedhimisht nuk janë raportuar as në nenin 19 të PVF (Raport për pasuritë jo financiare). Ndonëse, komuna ka shpalosur në një aneks të PVF-ve një listë të veçantë të pasurive, disa me vlerë 12,088,860€ dhe pasuri tjera të pavlerësuar të cilat konsiderohen materiale (toka dhe objekte të ndryshme), megjithatë, këto nuk janë regjistruar në SIMFK dhe nuk janë raportuar drejt në PVF. Po ashtu, pasuritë kapitale (blerjet e vitit) me vlerë të përbashkët prej 72,580€ nuk janë regjistruar në SIMFK. Mëtej, pasuritë jo kapitale (nën 1,000€) me vlerë të përbashkët prej 102,290€ nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria.
- C2 Komuna kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve ku nga kategoria ekonomike investime kapitale kishte pagur për kategorinë që për nga natyra klasifikohen mallra dhe shërbime në vlerë 79,416€, dhe 32,892€ për paga dhe mëditje.
- C3 Obligimet për pagat e 62 punonjësve të Drejtorisë së Arsimit për paga të bartura nga viti paraprak 2021, Komuna nuk i kishte prezantuar dhe shpalosur në PFV-të.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Mitrovicës së Jugut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna kishte bërë blerjen e artikujve për servisimin e automjeteve jashtë Kontratës me vlerë prej 3,760€.
- A2 Komuna kishte bërë subvencionimin e OJQ-ve në kundërshtim me kriteret e Ftesës Publike dhe Rregulloren e Financimit Publik të OJQ-ve.
- A3 Komisioni i inventarizimit të pasurive nuk kishte arrit që ta kryej këtë proces për të gjitha institucionet vartëse të saja si ato shëndetësor dhe arsimore.
- B1 Komuna gjatë vitit 2022 kishte kryer pagesa në vlerë prej 5,229,080€ apo 1,735 pagesa të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor për pagesë, vonesat janë nga 1 deri në 662 ditë. Si pasojë e vonesave, 3,615,609€ janë paguar nga Thesari përmes procedurave të përmbarimit.
- A4 Në katër (4) raste kemi vërejtur që, menaxherët e kontratave nuk kishin përgatitur planin për menaxhimin e kontratës.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Mitrovicës së Jugut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Mitrovicës së Jugut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Mitrovicës së Jugut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: moszbatim i procedurave të duhura të prokurimit, vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara, menaxhimin e të arkëtueshmeve, keqklasifikimi i shpenzimeve në kategori jo adekuate, si dhe dobësitë në menaxhimin e pasurive përfshirë edhe kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 11 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe pesë (5) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja C1 - Menaxhim jo i duhur i regjistrave të pasurive

Gjetja

Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, neni 6, definon qartë se çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Më tej, potencohet se regjistri i pasurive duhet të përfshijë pasuritë kapitale mbi 1,000€ të cilat duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuritë jo kapitale nën 1,000€ dhe stoqet në sistemin E-pasuria.

Pasuritë kapitale që janë në menaxhim të komunës (tokat, parcelat, lokalet, dhe objektet të ndryshme afariste, objekte shkollore, shëndetësore, sportive dhe kulturore). Komuna nuk i ka regjistruar në SIMFK të cilat rrjedhimisht nuk janë raportuar as në nenin 19 të PVF (Raport për pasuritë jo financiare). Ndonëse, komuna ka shpalosur në një aneks të PVF-ve një listë të veçantë të pasurive, disa me vlerë 12,088,860€ dhe pasuri tjera të pavlerësuara të cilat konsiderohen materiale (toka dhe objekte të ndryshme), megjithatë, këto nuk janë regjistruar në SIMFK dhe nuk janë raportuar drejt në PVF.

Po ashtu, nga mostrat e testuara (përfshirë blerjet e vitit) kemi gjetur se në pesë (5) raste, pasuritë kapitale (mbi 1,000€) me vlerë të përbashkët prej 72,580€ nuk janë regjistruar në SIMFK. Më tutje, në shtatë (7) raste tjera pasuritë jo kapitale (nën 1,000€) me vlerë të përbashkët prej 102,290€ nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria. Këto të fundit në pasqyra janë raportuar në bazë të shënimeve që mbahen në formatin Excel.

Shkaku për menaxhimin jo të duhur të regjistrave të pasurive janë veprimet e pamjaftueshme të komunës në drejtim të menaxhimit të duhur të

pasurive, përfshirë mungesën e evidentimit dhe vlerësimin të pasurive dhe azhurnimit të regjistrave.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pasurive të Komunës në regjistrat e pasurive, ndikon në mungesë të informatave të menaxhmentit në lidhje me pasuritë që posedon komuna, dhe paraqet mos përbushje të kërkesave ligjore në lidhje me evidentimin e pasurive. Po ashtu kjo ndikon në shpalosje të pasaktë të informatave për pasuritë në PFV.

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë vlerësuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës, në mënyrë që prezantimi i informatave për pasuritë në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Po ashtu, sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet dhe të regjistrohen pasuritë nën 1,000€.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C2 - Keqklasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013, shpenzimet duhet të regjistrohen në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Nga pagesat e kryera direkt nga Thesari përmes përmbarimit dhe vendimeve Gjyqësore të cilat gjatë vitit 2022 ishin në vlerë 3,615,609€, shuma prej 32,892€ janë bërë nga Investimet Kapitale përderisa kishin të bëjnë me kompenzim të pagave. Poashtu nga pagesat e kryera nga Komuna shuma prej 79,416€, ishte paguar nga Investimet Kapitale, për blerjen e artikujve që i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Sa i përket pagave dhe mëditjeve kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur shënime të sakta se sa mund shpenzohen për këtë kategori. Derisa pjesa tjetër është pasojë e mos planifikimit të mirë të shpenzimeve.

Ndikimi Keqklasifikimi i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategoritë përkatëse të shpenzimeve dhe në paraqitje jo të saktë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi C2 Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që të gjitha pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C3 - Mos raportimi dhe shpalosja e obligimeve për pagat e punonjësve të arsimit

Gjetja

Rregullorja MF 01/2017 , neni 8, thekson se pasqyrat financiare duhet të përmbajnë raport për detyrimet e papaguara.

Obligimet për pagat e 62 punonjësve të Drejtorisë së Arsimit për paga të bartura nga viti paraprak 2021, Komuna nuk i kishte prezantuar dhe shpalosur në PFV-të e saja të cilët ishin angazhuar me kontrata të përkohshme dhe pa procedura të rekrutimit, nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Për këta punësuar, Komuna nuk ka ofruar vlera financiare.

Sipas konfirmimit të pranuar nga DKA, nuk mund të ketë bazë të saktë të të dhënave për këto obligime, prandaj dhe nuk mund të deklarohet/raportohet shuma e saktë në PFV.

Ndikimi

Mos raportimi i obligimeve ndikon në cilësinë dhe saktësinë e informatave të shpalosura në PFV.

Rekomandimi C3

Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e papaguara ndaj punëtorëve të njihen dhe të raportohen në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Blerja e artikujve për servisimin e automjeteve jashtë Kontratës

Gjetja Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.20 përcakton se Menaxheri i Kontratës do të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës.

Gjatë testimit të gjashtë (6) pagesave për kontratën kornizë tre-vjeçare “Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të Komunës dhe Institucioneve tjera Komunale” me vlerë 150,000€, kemi gjetur se në secilën faturë janë paguar artikuj të cilët nuk kanë qenë fare të përfshirë në kontratë, ku nga vlera totale e gjashtë faturave prej 5,614€, shuma prej 3,760€ apo 67% është bërë për artikuj që nuk kanë qenë të përfshirë në kontratë, ndërsa faturimi pohohet se është bërë sipas çmimeve të tregut.

Deri te kjo situatë ka ardhur si rezultat i veprimeve të menaxherit të kontratës, përgatitjes së mangët të kontratës fillestare, si dhe mos-zbatimit të procedurave të përgjithshme për procedimin e pagesave, siç përcaktohet me kërkesat ligjore.

Ndikimi Blerja e artikujve jashtë kontratës përveç që është e ndaluar, paraqet rrezik të humbjeve të panevojshme të fondeve të Komunës si rezultat i mbi-faturimit potencial që mund të bëhet nga operatori ekonomik.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës do të përgatisin kontrata adekuatë të cilat edhe do të respektohen në përpikëri nga menaxherët e kontratave. Si dhe, të sigurojë zbatim të procedurave të përgjithshme për procedimin e pagesave, që parandalojnë parregullsitë e lartpërmendura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Subvencionimi i OJQ-ve në kundërshtim me kriteret e Ftesës Publike dhe Rregulloren e Financimit Publik të OJQ-ve

Gjetja Në “Ftesën Publike për Projektet për OJQ-të për Rini për vitin 2022” të datës 07.04.2022, dhe në “Ftesën Publike për Projektet Kulturorë-Artistike për OJQ, thirrja e dytë për vitin 2022” të datës 21.10.2022, disa prej kriterëve kanë qenë: Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit, Deklaratë mbi financimin e dyfishtë, Vërtetimin që OJQ-ja nuk ka obligime tatimore, dhe paraqitja e provave se personi përgjegjës/menaxheri në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale. Ndërsa, Manuali i Rregullores së MF - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përcakton formën për të vlerësuar cilësinë e aplikacioneve (Formulari F15).

Gjatë testimit të tre (3) përfituesve të subvencioneve kemi gjetur se Klubi i

Basketbollit Trepça (shuma e përfituar 27,000€) kishte dorëzuar Vërtetimin Tatimor, pas 70 ditëve nga mbyllja e Ftesës Publike, dhe nuk kishte ofruar prova se personi përgjegjës/menaxheri në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale; Klubi i Futbollit Trepça (shuma e përfituar 17,000€) nuk kishte ofruar deklaratën mbi financimin e dyfishtë, deklaratën mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit, dhe provat se personi përgjegjës/menaxheri në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale. Gjithashtu, OJQ Ad Libitum (shuma e përfituar 15,000€) nuk kishte ofruar prova se personi përgjegjës/menaxheri në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale.

Për më tepër, Komisioni Vlerësues nuk kishte përdorur formularin e obliguar për vlerësimin e cilësisë së aplikacioneve (F15) në asnjërën prej Ftesave të mësipërme, me anë të cilit do të bëhej poentimi i saktë i aplikacioneve për ta bërë renditjen dhe kualifikimin/eliminimin e aplikuesve për subvencion, dhe si rezultat nuk kemi mundur të konkludojmë me siguri se si është arritur deri tek kualifikimi/eliminimi i aplikuesve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i shpërfilljes së kriterëve të Ftesave Publike nga Komisioni Vlerësues dhe anashkalimi i procedurave të Rregullores.

Ndikimi

Çështjet e sipër përmendura, përveç që janë në kundërshtim me Ftesën Publike dhe Rregulloren, gjithashtu nuk garantojnë se vlerësimi është kryer siç duhet dhe fondet iu janë dhënë përfituesve meritator.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të ndërmerr masa të menjëhershme për të siguruar se zyrtarët të cilët janë përfshirë në proceset e dhënies së subvencioneve të respektojnë kriteret e Ftesave Publike dhe të Rregullores, në mënyrë që të mos përsëriten devijimet e sipër përmendura.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Inventarizim jo i plotë i pasurive

Gjetja

Rregullorja MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore përcakton në mënyrë të qartë mënyrën se si duhet të bëhet inventarizimi i pasurisë.

Komuna kishte themeluar komisionin për inventarizimin e pasurisë dhe i njëjti e ka hartuar një raport të inventarizimit ku janë përfshirë pasuritë me vlerë nën 1,000€ të drejtorive komunale dhe disa institucioneve komunale, por jo edhe ato të shkollave dhe Institucioneve shëndetësore. Po ashtu, pasuritë me vlerë mbi 1,000€ nuk janë përfshirë në raportin e inventarizimit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të plotë të kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive, dhe mungesës së kontrolleve të brendshme.

Ndikimi

Mos përfshirja e të gjitha pasurive në procesin e Inventarizimit i pamundëson zyrtarët të pasurive krahasimin/ harmonizimin e regjistrave të pasurive me raportin e inventarizimit dhe për pasojë mund të vie deri te mungesa e korrigjimeve eventuale të regjistrave.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë që komisionet e caktuara për inventarizim, të përfshijnë të gjithë pasurinë e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbartimore**Gjetja**

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2022 kishte kryer pagesa në vlerë prej 5,229,080€ apo 1,735 pagesa të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor për pagesë. Vonesat variojnë nga 1 deri në 662 ditë. Këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me Investime Kapitale, Mallra dhe Shërbime, dhe Paga e Mëditje. Si pasojë e vonesave, 3,615,609€ janë paguar nga Thesari përmes procedurave të përmbartimit. Komuna nuk ka informata se sa ishte borxhi dhe sa mjete janë paguar për shpenzime të përmbartimit/gjykatës.

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit jo të duhur, hyrja në obligime pa pasur mjaftueshëm mjete si dhe neglizhenca e zyrtarëve përgjegjës për kompletimin e lëndëve për pagesë.

Ndikimi

Mos pagesa e faturave dhe obligimeve me kohë e ekspozon Komunën ndaj padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore dhe të kamatave. Kjo poashtu e prish planin e shpenzimeve dhe pamundëson arritjen e objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhen brenda afateve kohore ligjore dhe të mos të shkaktohen obligime pa pasur mjete të mjaftueshme, me qëllim që mos të dëmtohet më tej buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Mungesa e Planeve të Menaxhimit të Kontratave**Gjetja**

Rregulla dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Pika 61.7 dhe 61.8 përcaktojnë se "Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës (për të gjitha kontratat me vlerë të madhe, të mesme dhe të vogël) dhe me pajtimin e palëve të kontratës. Kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dy palëve, përkatësisht të Menaxherit të Kontratës nga ana e AK dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik."

Gjatë testimit të pesë lëndëve për pajtueshmëri me procedura, kemi konstatuar se në katër raste nuk ishte përgatitur Plani për Menaxhimin e Kontratës, ndërsa në një rast kishte plan, por nuk ishte nënshkruar nga ana e Operatorit Ekonomik. Rastet janë për kontratat në vijim: (Furnizim me lëndë Djegëse Pelet për Institucione Komunale; Mirëmbajtja Verore e Rrugëve në Qytet dhe Periferi-Lloti I; Mirëmbajtja Higjeniko-Sanitare [Pastrimi] i objektit të Komunës dhe Institucioneve tjera; Ofrimi i Shërbimeve Kontraktuese Shëndetësore-tri vite ose 36 muaj; dhe Ofrimi i Shërbimeve Juridike për Nevojat e Komunës së Mitrovicës).

Arsyeja përse ka ndodhur kjo është se menaxherët e kontratave nuk kanë ftuar Operatorët Ekonomik për t'u dakorduar dhe për ta nënshkruar planin.

Ndikimi

Si rezultat i mungesës së planeve Autoriteti kontraktues nuk do të ketë informata në lidhje me njoftimin mbi fillimin e punëve, afatin e përmbushjes, dhe progresin e kontratës në përgjithësi.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë se të gjithë menaxherët e emëruar të kontratave, të dakordohen me operatorët ekonomik në lidhje me ecurinë e kontratës, ku planet për menaxhimin e kontratës të nënshkruhet nga të dyja palët.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut në vitin 2022 ishin në vlerë 2,996,807€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet ndërtimore, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, etj. Po ashtu kishte kthim të mjeteve nga të hyrat e vitit të kaluar në vlerë prej 324,073€. Përveç të hyrave të lartpërmendura, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat mbledhen nga niveli qendror në vlerë prej 303,495€ (gjobat në trafik 245,491€, gjobat nga Agjencia e pyjeve 1,179€, si dhe nga Gjykata 56,825€).

Çështja C4 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja

Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë është identifikuar se më shumë se 4,000 tatimpagues të prezantuar në këtë bazë, nuk kanë të prezantuar numrat personal, të cilët në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë përfitues të disa hershëm nga zbritja e lejuar ligjore.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat personal të tatimpaguesve mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor.

Rekomandimi C4

Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të kenë përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Të arkëtueshmet

Në PFV e vitit 2022 janë shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 13,556,875€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, tarifat komunale të pa arkëtuara, të arkëtueshmet për mbledhjen e mbeturinave , të arkëtueshmet nga qiraja, etj. Në krahasim me vitin paraprak, LLA janë rritur për 806,154€ apo për mbi 6%. Sfidë mbetet ende arkëtimi i LLA.

Çështja C5 - Mangësi në menaxhimin e dosjeve të LLA

Gjetja

Pjesa e pasme e faturës së taksës komunale për Ushtrim të Veprimtarisë Afariste përcakton që taksa për biznesin llogaritet në baza vjetore bazuar në Rregulloren Komunale për Taksa Tarifa dhe Gjobat dhe pagesa mund të bëhet në 4 këste pa kamatë dhe gjobë, mirëpo pas kalimit të afateve ligjore të parapara për pagesë, Komuna do të aplikojë inkasim të detyrueshëm. Ndërsa kontratat e lidhura për qiradhënie për prona komunale ,specifikojnë se shumat e qirasë paguhen në baza mujore.

Ne kemi testuar 70 mostra për LLA, ku gjatë testimit të këtyre mostrave kemi gjetur se pothuajse asnjë nga lëndët e testuara nuk përmbajnë komplet faturat e paguara dhe ato të pa paguara nga qiradhënësit, ku faturat lëshohen nga Komuna vetëm me kërkesë të borxhliut. Mangësi janë paraqitur edhe në LLA tjera të testuara. Prandaj nuk mund të konfirmohet se kartelat e borgjeve, dhe shumat e shpalosur e llogarive të arkëtueshme janë të sakta.

Kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së stafit dhe mos përcaktimit të saktë të personave/departamenteve përgjegjëse për menaxhimin e dosjeve të të arkëtueshmeve.

Ndikimi

Mos kompletimi i dosjeve/kartelave të borxhlinjve nuk japin siguri se borxhi është i saktë dhe i plotë.

Rekomandimi C5

Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të ndërmarrin veprime për plotësimin e lëndëve të borxhlinjve, në mënyrë që të ketë dëshmi që ofrojnë siguri se shumat e paraqitura të LLA janë të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit-Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Komuna po ashtu ka themeluar komitetin e auditimit i cili është funksional. NjAB përveç planit strategjik kishte hartuar Planin Vjetor për vitin 2022 dhe deri në fund të vitit kishte finalizuar gjashtë raporte të Auditimit, aq sa ishin planifikuar. Auditimet kanë mbuluar fushën e prokurimit, dhënien në shfrytëzim të pronave publike, departamentin administratës etj. Dy nga auditimet kishin në fokus vitin 2022 derisa të tjerat vitet paraprake. Komuna po ashtu ka të themeluar edhe Komitetin e Auditimit i cili ishte funksional dhe gjatë vitit kishte mbajtur 5 takime.

Çështja B2 - Zbatimi i ulët i rekomandimeve të NJAB-së

Gjetja Sipas udhëzimit administrativ nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit për sektorin publik, neni 7, paragrafi 1.7 thekson se Komiteti i auditimit shqyrton raportet përmbledhëse, gjetjet, rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe siguron që ato janë adresuar siç duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik.

Nga vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NjAB është vërejtur zbatim i ulët i rekomandimeve. Nga rekomandimet e dhëna nga viti 2019 e tutje, 31 rekomandime ishin zbatuar, 35 ishin në proces dhe 26 ishin të pazbatuara.

Shkaku i mos zbatimit të rekomandimeve është mungesa e planeve të veprimit dhe mungesa e një procesi formal të monitorimit të tyre nga menaxhmenti.

Ndikimi Mos implementimi i rekomandimeve të NjAB-së ndikon në përsëritjen e gabimeve dhe dobësive të identifikuara nga auditimi i brendshëm.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm do të përcillen me një plan veprimi për implementimin e tyre si dhe një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	20,725,817	23,596,277	21,820,579	22,394,096	21,203,738
Grante Qeveritare - Buxheti	18,389,960	19,017,305	18,275,865	19,306,154	18,874,382
Financimi përmes huamarrjes	0	179,614	179,614	60,955	115,801
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,332,225	1,326,326	715,326	441,740
Të hyrat vetanake	2,335,857	2,525,766	1,886,661	2,248,778	1,316,604
Donacionet vendore	0	73,105	10,687	45,555	49,084
Donacionet e jashtme	0	468,261	141,426	17,328	406,127

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 2,870,458€. Rritja ishte kryesisht si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar me vlerë 1,332,225€, nga granti qeveritare në vlerë 627,343€, nga financimi i huamarrjes 179,614€, nga rishikimi i planit për të hyrat me vlerë 189,910€, si dhe nga donacionet 541,366.

Në vitin 2022 Komuna e Mitrovicës Jugore ka shpenzuar rreth 92% të buxhetit përfundimtar ose 21,820,579€, me një ulje të përqindjes prej 6% në krahasim me vitin 2021.

Sa i përket buxhetit për vitin 2022 duhet të theksojmë se Kuvendi Komunal i Komunës së Mitrovicës nuk kishte arritur që ta aprovoj buxhetin brenda aftëve të parapara ligjore, ku pastaj Qeveria ka nxjerr Vendim dhe ka dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës për aprovimin dhe miratimin e buxhetit për komunën.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	20,725,817	23,596,277	21,820,579	22,394,096	21,203,738
Pagat dhe mëditjet	12,599,659	12,686,535	12,230,685	13,614,018	12,187,045
Mallrat dhe shërbimet	2,962,493	3,657,902	3,480,368	3,047,293	3,338,650
Komunalitë	457,214	488,008	486,757	466,332	382,851
Subvencionet dhe transferet	586,114	1,192,273	1,153,132	956,418	718,371
Investimet Kapitale	3,727,337	5,571,560	4,469,637	4,310,034	4,576,821
Rezervat	393,000	0	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 204,178€ si rezultat i të hyrave të bartura, huasë, dhe grantit qeveritar. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 96%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 327,060€ në krahasim me buxhetin fillestar si rezultat i të hyrave vetanake të bartura dhe donacioneve. Ndërsa ekzekutimi i buxhetit është relativisht i lartë në këtë fushë me rreth 95%.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit kishte arritur mbi 99%.
- Buxheti final për Subvencione dhe transfere ishte rritur për 555,773€ në krahasim me buxhetin fillestar, si rezultat i të hyrave vetanake të bartura dhe granteve të donatorëve. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 97% e buxhetit final.
- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 982,554€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura dhe donacioneve. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 80%.
- Mjetet e shpenzuara në vitin 2022 për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 179,614€. Ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në arsim dhe shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Mitrovicës së Jugut në vitin 2022 ishin në vlerë 2,996,807€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet ndërtimore, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, etj. Po ashtu kishte kthim të mjeteve nga të hyrat e vitit të kaluar në vlerë prej 324,073€. Përveç të hyrave të lartpërmendura, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte të cilat mbliidhen nga niveli qendror në vlerë prej 303,495€ (gjobat në trafik 245,491€, gjobat nga Agjencia e pyjeve 1,179€, si dhe nga Gjykata 56,825€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	2,335,857	2,335,857	2,996,807	3,271,712	1,766,659
Të hyrat tatimore	934,702	934,702	1,073,382	1,002,543	645,927
Të hyrat jo tatimore	1,401,155	1,401,155	1,923,352	2,207,385	1,120,732
Të hyrat tjera	0	0	72	61,784	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021, ka rezultuar në 17 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2021 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, dhjetë rekomandime janë zbatuar, pesë (5) janë në proces të zbatimit dhe dy (2) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari, duhet të sigurojë se janë ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar, vlerësuar dhe regjistruar në regjistrat përkatës, për siguruar që prezantimi i informatave për pasuritë në PFV të jetë i saktë dhe i plotë. Po ashtu sistemi e-pasuria duhet të funksionalizohet dhe të regjistrohen pasuritë nën 1,000€.	Komuna pjesërisht kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim, por edhe më tutje Pasuritë kapitale që janë në menaxhim të komunës (tokat, parcelat, lokalet, dhe objektet të ndryshme afariste, objekte shkollore, shëndetësore, sportive dhe kulturore), Komuna nuk i ka regjistruar në SIMFK të cilat rrjedhimisht nuk janë raportuar as në nenin 19 të PVF. Komuna i kishte regjistruar në SIMFK në muajin mars të vitit 2023.	Pjesërisht i zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesat të realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të shpenzimeve në PFV, në përputhje me planin kontabël të Thesarit.	Vlera e keqklasifikimeve është zvogëluar dukshëm, megjithatë akoma nuk është eliminuar plotësisht si dukuri.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë, në mënyrë që për projektet e përfunduara të finalizoj procesin e regjistrimit të pasurisë.	Komuna kishte marr masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar

4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se pozitat e lira të punës plotësohen nëpërmjet procedurave të rregullta të rekrutimit përmes konkursit publik dhe punonjësit të përfshihen në listën e pagave. Po ashtu në rast se Komunës i mbeten obligime të papaguara ndaj punëtorëve, ato obligime duhet të raportohen në PFV.	Angazhimi i stafit përgjatë vitit 2022 është bërë përmes konkurseve dhe procedurave të rregullta të rekrutimit, mirëpo obligimet për punonjësit të cilët në vitin 2021 ishin angazhuar pa konkurs, nuk janë njohur dhe nuk janë shpalosur në pasqyrat financiare.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që gabimi i tillë të korrigjohet duke bërë përpjekje për zgjidhje të marrëveshjes dhe të kërkojë që shuma e kontraktuar të korrigjohet dhe nënshkruhet nga të dyja palët.	Gjatë testimit të mostrave në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve nuk kemi hasur probleme me vlerën e parashikuar të kontratës, menaxhmenti kishte marr masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe përcaktimit të çmimit/vlerës së kontratave, të respektohen në mënyrë rigoroze kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe rregullat e udhëzimit përcjellëse.	Meqenëse gjatë auditimit nuk kemi gjetur raste të ngjajshme, konsiderojmë se ky rekomandim është zbatuar.	I zbatuar
7.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se Thirrjet Publike për subvencionimin të fermerëve të përmbajnë kritere të qarta të cilat plotësohen me dokumentet e kërkuara, dhe se Komisionet e Vlerësimit të vlerësojnë aplikacionet në përputhje të plotë me kriteret e shpallura në Thirrje Publike.	Gjatë testimit të thirrjeve publike për subvencionim në fushën e bujqësisë, nuk kemi gjetur raste ku nuk janë respektuar kriteret e thirrjes, menaxhmenti kishte marr masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar

8.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet që të sigurojë se për të gjitha subvencionimet e OJQ-ve që kualifikohen për t'u trajtuar sipas Rregullores së lartpërmendur të shpallet Thirrje Publike dhe të aplikohen kërkesat që rrjedhin nga kjo Rregullore.	Si pjesë e mostrimit nuk kemi hasur raste të tilla menaxhmenti kishte marr masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
9.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr veprime të menjëhershme të identifikimit të të gjithë përfituesve të disahershëm të zbritjes së vendbanimit parësor dhe t'i ndërmarrin masat ligjore, si dhe të plotësojnë bazën e të dhënave me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, në mënyrë që të verifikohen të gjitha rastet.	Janë evidentuar dhe eliminuar përfituesit e dyfishtë të cilët kanë qenë të evidentuar në bazë të numrit personal në sistem, megjithatë ka raste të shumta kur tatimpaguesit nuk e kanë të regjistruar numrin personal dhe të njëjtit kanë mundësi të përfitojnë më shumë se një herë nga zbritja për banim primar.	Pjesërisht i zbatuar
10.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar burime të nevojshme për Departamentin e Tatimit në Pronë, qoftë përbrenda Komunës apo edhe të angazhojë inspektorë privat në pajtim me dispozitën ligjore, në mënyrë që të përmbushen këkesat ligjore të inspektimit të pronave komunale.	Komuna ka arritur që në vitin 2022 të inspektojë mbi 20% të pronave të tatimpaguesve dhe ky rekomandim konsiderohet që është adresuar.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që Njësia e Prokurimit të bëjë planifikime të duhura dhe me kohë në mënyrë që afatet kohore të përshpejtuara të eliminohen ose të përdorën minimalisht në mënyrë që të mos dëmtohet konkurrenca dhe potencialisht buxheti i Komunës për mallrat/punët/shërbimet e siguruara. Njëkohësisht duhet të siguroj që pas përfundimit të vlerësimit të ofertave të mos vonohet nënshkrimi i kontratave në mënyrë që të fitohet kohë për realizimin e projekteve.	Gjatë auditimit për vitin 2022 nuk kemi gjetur se ka probleme të tilla me afatet kohore në proceset e prokurimit, prandaj konsiderojmë se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar

12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore dhe nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar/aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe mos të krijohen vështirësi financiare për komunën.	Komuna kishte marr masa për ta adresuar këtë rekomandim dhe nuk kemi raste të tilla.	I zbatuar
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.	Rekomandimi është zbatuar si dhe janë ndërmarrë veprime për dërgimin e rasteve tek përmbaruesi.	I zbatuar
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të adresojë problemet e lartpërmendura duke ndërmarrë masa ligjore ndaj borxhlinjve sipas kushteve të dakorduara, të trajtohen kontratat e skaduar sipas procedurave të parapara, dhe të dërgojnë faturat tek borxhlinjtë si përkujtim apo dhe vërejtje në lidhje me shumën që duhet paguar. Gjithashtu, zyrtarët të ndërmarrin veprime për plotësimin e lëndëve të borxhlinjve, në mënyrë që të ketë dëshmi që ofrojnë siguri se shumat e paraqitura të LLA janë të sakta.	Rekomandimi është zbatuar pjesërisht, ndërsa ende vazhdojnë mangësitë për menaxhimin e dosjeve të LLA.	Pjesërisht i zbatuar
15.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Edhe në vitin 2022 kishte vonesa në pagesën e faturave.	Nuk ka filluar zbatimimi
16.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë që informatat rreth detyrimet kontigjente azhurnohen rregullisht dhe të njëjtat prezantohen drejtë në PFV, duke përfshirë vlerësimet financiare për secilën padi.	Avokati i komunës e ka hartuar regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe në të ka përfshirë të gjitha paditë për të cilat ka pasur informata dhe dokumente për ti raportuar.	I zbatuar
17.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një plan veprimi për implementimin e tyre si dhe një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e zbatimit të tyre.	Nuk duket që janë marrë masa pasi që niveli i implementimit është ende i dobët.	Nuk ka filluar zbatimimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Bujar Bajraktari, Udhëheqës i ekipit



Gazmend Namani, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Menaxhim jo i duhur i regjistrave të pasurive	<p>Duke e vlersuar gjendjen jo te duhur të regjistrave të pasurisë dhe rekomandimet e Zyres Kombëtare të Auditimit për vitin 2021, Kryetari i Komunës ka formuar një komision për Vlerësimin e pasurisë jofinanciare të Komunës së Mitrovicës. Komisioni është profesional dhe me përfaqësim të drejtorive kyçe të involvuara në çështjen e Pasurisë jofinanciare të Komunës.</p> <p>Nga formimi i këtij komisioni është bërë vlerësimi i gjithsej 192 parcelave që në vlerë financiare është 43,836,833.00 euro. Zyrtarja për Pasuri posa është lejuar çasja në SIMFK (Sistemi ka qenë jo funksional deri në Prill 2023) ka fillu me regjistrimet e parcelave të vlerësuara nga Komisioni dhe deri më tani në SIMFK janë regjistruar gjithsej 12,088,860.00 Euro.</p> <p>Regjistrimi i Pasurisë me komision profesional nuk ka ndodhur ndonjëherë deri më tani në Komunën e Mitrovicës (nga viti 1999 e tutje) dhe Zyra Kombëtare e Auditimit pothuajse në çdo vit e ka trajtuar si temë dhe gjithmonë kanë dhënë rekomandime duke u bazuar në gjetjet e tyre.</p> <p>Duke e vlersuar ndjeshmërinë e kësaj çështje do të ndërmarrim veprime për të shtuar numrin e anëtarëve në këtë Komision për të shtuar dinamikën e punës.</p> <p>Gjithashtu duke u bazuar në rekomandimet e Zyres Kombetare të Auditimit, Komuna e Mitrovicës së fundi ka shtuar zyrtarët për pasuri, ku pas procedurave të rekrutimit në Drejtorinë e Shëndetësisë (QKMF) është punësuar një zyrtare për Pasuri.</p> <p>Gjithashtu iu njoftojmë se ne kemi kontaktuar me zyrtaret e ASHI për të filluar regjistrimin pasuritë jo-kapitale</p>	<p>E gjetura e auditorit mbetet, pasi që Komuna pasuritë kapitale që janë në menaxhim të komunës (tokat, parcelat, lokalet, dhe objektet të ndryshme afariste, objekte shkollore, shëndetësore, sportive dhe kulturore), nuk i kishte regjistruar në SIMFK, të cilat rrjedhimisht nuk janë raportuar as në nenin 19 të PVF-ve.</p>

	(nen 1,000.00 Euro) mirpo ata na kanë njoftuar se sistemi E-Pasuria nuk është në funksion dhe se procedura për funksionalizimin e tij janë në Prokurim e sipër. Gjithsesi zyrtarja në fjalë na ka rekomanduar të vazhdojmë të punojmë në të njëjtën mënyrë (pa i regjistruar në e-Pasuria) deri në njoftim të radhës.	
Keqklasifikimi i shpenzimeve	<p>Keqklasifikimi i Shpenzimeve në të gjeturat e Auditorit e ka vlerën 79,000 Euro që në krahasim me totalin e Buxhetit të shpenzuar në vitin 2022, keqklasifikimi është 0.36%.</p> <p>Krahasuar me të gjeturat e vitit paraprak keqklasifikimi ishte mbi 580,000.00 Euro, besojmë që në këtë vit keqklasifikimi nën 1% nuk mund të jetë bazë për Opinionin e KUALIFIKUAR të Zyres Kombetare të Auditimit dhe duhet të merret për bazë progresi të cilin Komuna e Mitrovicës e ka realizuar gjithmonë duke u bazuar në rekomandimet e Zyres Kombetare të Auditimit.</p> <p>Gjithsesi ekzekutimi i këtyre pagesave nuk është i kryer në Komunën e Mitrovicës, por nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Thesarit të cilë kanë kryer ekzekutimin e pagesave përmes vendimeve gjyqësore.</p>	Komuna kishte ndërmar masa duke e zvogluar vlerën e keqklasifikimeve nese e krahasojm me vitin 2021, por edhe në këtë vite kishte keqklasifikime për vlerën që e kemi theksuar në raport.
Mos raportimi dhe shpalosja e obligimeve për pagat e punonjësve të arsimit	<p>Punonjësit (62) të cilët kanë poseduar kontrata pune dhe të cilët nuk i janë nënshtruar procedurave të Konkursit rrjedhimisht mund të konsiderohen si jo të rregullt, sepse ashtu edhe sic është cekur në Raportin e Auditimit për Komunen e Mitrovicës për vitin 2021 - Çështjen A3, procesi i tillë mund të ndikoj në përzgjedhjen e kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret për mësimdhënie.</p> <p>Drejtorja e Arsimit nuk ka informatë se mbi çfarë baze ligjore janë nënshkruar kontratat për këta 62 punonjës sepse konkurset janë anuluar dhe rrjedhimisht nuk janë</p>	E gjetura e auditorit qëndron si e tillë, si vazhdimësi nga viti paraprak auditues, ku obligimet për pagat e punëtorëve nuk janë prezantuar dhe shpalosur në PFV.

nënshkruar në mënyrë zyrtare (përmes konkursit publik dhe vlerësimit të barabartë të mësimdhënësve - kandidatë potencial) dhe si të tillë ata nuk mund të konsiderohet punonjës të rregulltë ligjor të Komunës së Mitrovicës. Ashtu sic ceket në Çështjen A3 të raportit të ZKA për vitin 2021 për cdo themelim të marrdhenies së punës duhet të shpallet konkurs publik.

Citim “Çështja A3 për PVF 2021 (Gjetja) : Sipas nenit 8 të ligjit të punës Nr.03/L-212, Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.”
Rekomandimi A3 për PVF 2021 : Kryetari duhet të sigurojë se pozitat e lira të punës plotësohen nëpërmjet procedurave të rregullta të rekrutimit përmes konkursit publik dhe punonjësit të përfshihen në listën e pagave

Obligimet financiare të cilat kanë dalur nga këto kontrata, Drejtoria e Arsimit nuk mund të ketë një bazë të sakt të të dhënave sepse disa nga këta punonjës potencialisht mund ti kene ekzekutuar përmes Gjykatave, mund ti kenë ndërprere në gjysmë ato kontrata ose mund të kene themeluar marrdhenie pune me Komunën e Mitrovices ose ndonjë institucione tjetër dhe Drejtoria e Arsimit nuk ka informata rreth tyre. Prandaj nuk mund të deklarohet një shumë e cila nuk është 100% e sakt në PVF. Gjithsesi Pranimi i këtyre obligimeve do të ishte legjitimim i kontratave të punës (62) të cilat janë nënshkruar pa ndonjë procedure të konkursit të hapur e të cilat Drejtoria e Arsimit por edhe raporti i ZKA për Komunën e Mitrovicës për vitin 2021 i ka konsideruar si jo të rregullta dhe me ndikim negativ.

Në komunikim e sipër me Divizionin e Pagave në Ministrinë e Financave, për çdo procedim për punëtor të rinjë në listat e pagave kërkohet konkursi

si bazë kryesore për themelimin e marrdhenies së punës për procedimin e tyre në Listat e Pagave. Ne kemi pranuar disa kërkesa nga disa përfitues të këtyre kontratave (62) për kompensimin e tyre sipas këtyre kontratave dhe në përgjigje Drejtoria e Arsimit ka kërkuar që nga parashtruesit e kërkesave që në kërkesë të bashkangjesin edhe konkursin ose procedurën përmes të cilës ata janë zgjedhur (sepse Drejtoria e Arsimit nuk ka poseduar një procedure te tille në arkivin e saj).

Gjithashtu me datën 15.03.2022, Drejtoresha e Arsimit me shkresë zyrtare i është drejtuar Ministres së Arsimit znj.Arberie Nagavci dhe gjithë menaxhmentit të MASHTI (bashkangjitur mund të gjeni shkresën), me kërkesë për angazhimin e tyre në realizimin e këtyre pagave, mirpo nuk ka marrur ndonjë përgjigje.

Rrjedhimisht pas refuzimit të Ministrisë së Financave dhe mos përgjigjes nga ana e Ministrisë së Arsimit, këta punonjës janë konsideruar si të parregulltë. Përfshirja e tyre në PVF do të nënkuptonte legjitimimi i tyre.

<p>Blerja e artikujve për servisimin e automjeteve jashtë Kontratës</p>	<p>Pagesat e kryera për gjashtë (6) faturat e dalura nga kontrata “Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve të Komunës dhe Institucioneve tjera Komunale” me vlerë 150,000, janë fatura të cilat i kemi gjetur në listen e obligimeve nga vitet 2020 dhe 2021. Faturat janë të kompletuara me të gjitha dokumentet e nevojshme dhe të bazuara në pozicionet e Kontratës (Pjesa III e Kontratës me kushte të veçanta - Neni 24.1) .Kontrata është nënshkruar në vitin 2020 dhe është përfshirë në dy auditime nga ZKA para këtij Draft-Raporti (Raporti për vitin 2020 dhe 2021). Prandaj obligimet nuk janë të krijuara gjatë vitit 2022 dhe rrjedhimisht të gjeturën sit ë tillë nuk mund ta pranojmë sepse këto pagesa janë ekzekutuar nga lista e obligimeve nga vitet paraprake.</p> <p>Kontrata e nënshruar me datën 17.07.2023 me nr. Protokoli 642-20-920-211 dhe nr të Brendshëm 642/20/007/211 në vlerë 150,000.00 Euro.</p> <p>Bazuar në kushtet e veçanta Komisioni ka vlerësuar artikujt të cilët nuk ishin në specifika teknike të çmime.</p> <p>Gjithsesi obligime kontraktuale dhe lista e obligimeve të cilat i kemi të trashëguara kemi marrë rekomandim nga ZKA për shlyerjen e obligimeve. Në të ardhmen ne nuk do të procedojmë fatura për artikujt të cilët nuk gjinden në specifikimin Teknik të çmimeve. Gjithashtu kjo kontratë përfundon këtë vit dhe gjatë hartimit të specifikave të reja Komuna e Mitrovicës sigurisht që do të ketë parasysh të gjeturat e Zyres Kombetare të Auditimit.</p>	<p>E gjetura e auditorit mbetet. Fushëveprimi jonë përfshinë transaksionet e vitit 2022, jo ekskluzivisht vitin kur është krijuar obligimi. Ndërsa, sa i përket çmimeve të tregut për pajisjet që nuk kanë qenë të përfshira në kontratë, ato nuk janë të verifikuara pasi që nuk është dokumentuar asgjë dhe nuk është krijuar Komisioni 3 anëtarësh për këtë çështje, siç është përcaktuar në kontratë.</p>
-------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<p>Inventarizim jo i plotë i pasurive</p>	<p>Sa i përket inventarizimit të Pasurisë me vlera nën 1,000.00 Euro për Institucione Arsimore dhe Shëndetësore iu njoftojmë se të gjitha këto pasuri janë të evidentuara në regjistrat e Komunës për secilin objekt në veçanti. Së shpejti pritet të filloj edhe vlerësimi i tyre nga Komisionet përkatëse. Raportet e inventarizimit nuk janë kërkuar nga Ekipi Auditues për Institucionet Arsimore dhe Shëndetësore sepse të gjitha mund të ofrohen në kohë reale (me USB ose CD sepse volimi i lëndëve është shumë i madh) Komuna e Mitrovicës e ka krijuar komisionin për vlerësimin e E-kiosqeve, ku komisioni ka marrë vendim për të larguar nga lokacionet e vendosura për shkak që nuk mund të funksionalizohen dhe pajisjet e IT (të brendshme) janë vendosur në gjendje civile kurse korniza e jashtme në depo komunale. Duhet të ceket që e-kiosqet nuk janë shitur vetëm është bërë vlerësimi sipas nenit 21 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, për të ndjekur më tutje procedurat ligjore në fuqi. Të bashkangjitur gjeni raportin. Prandaj ne nuk mund të pranojmë si të gjetur termin “Shitje duke mos ndjekur procedurat ligjore” ose “Tjetërsim i pasurisë”. Edhe njëherë iu njoftojmë se E-kiosqet gjinden në Depotë e Komunës së Mitrovicës dhe kjo mund të vërtetohet në çdo moment edhe me vizita në këto Depo nga zyrtarët e Zyres Kombëtare të Auditimit.</p>	<p>Është marrë parasysh çështja e e-kiosqeve është larguar nga raporti i iauditimit, por sa i përket inventarizimit të të gjitha institucioneve të Komunës kjo çështje mbetet në raport pasi nuk na është ofruar dëshmi se është kryer ky proces në shkollave dhe Institucioneve shëndetësore.</p>
-------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

<p>Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbaremore</p>	<p>Duke u bazuar në vendimet e menaxhmentit të Komunës së Mitrovicës dhe krijimin e rregullsisë financiare si dhe rekomandimet e Zyres Kombëtare të Auditorit, ne në Buxhetin e vitit 2022 kemi planifikuar ekzekutimin e borxheve të prapambetura.</p> <p>Prandaj ne pjesën më të madhe të Buxhetit 2022 e kemi përdorur për ekzekutimin e listës së Borxheve e cilat në momentin e pranimi të mandatit qeverisës e deri në fund të vitit 2022, ka qenë mbi 6 milion euro.</p> <p>Vonesat në ekzekutim të pagesave nga 1 deri në 662 ditë, kanë të bëjnë me fatura të vjetra të trashëguara madje edhe nga viti 2016. Kjo mund të dëshmohet edhe nga Raportet e SIMFK të shpenzimit të Buxhetit.</p> <p>Rreth planifikimit të ekzekutimit të borxheve dhe faturave të vjetra, ne e kemi njoftuar edhe Ekipin Auditues gjatë fazës së Auditimit për vitin 2022.</p> <p>Meqë ne jemi fokusuar në ekzekutimin e borxheve të trashëguara, ne nuk mund të pranojmë se gjatë vitit 2022 ka pasur vonesa në pagesa deri në 662 ditë. Madje ne kemi insistuar që të mos krijohen obligime të reja pa zotime të mjeteve asnjëherë.</p> <p>Bashangjitur mund të gjeni vendimin e bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2021, ku pjesa e konsiderueshme e tyre janë përdorur për ekzekutimin e borxheve. Gjithashtu edhe në Planifikimin e Buxhetit 2022, ne kemi planifikuar ekzekutimin e pagesave me prioritet nga lista e obligimeve të papaguara.</p>	<p>E gjetura e auditorit mbetet pasi që testimet tona e kanë konfirmuar se ka vonesa në pagesën e faturave, këtë e ak konfirmuar edhe Komuna me komentet që i ka derguar tek ne ku e thekson se vonesat në ekzekutim të pagesave nga 1 deri në 662 ditë, kanë të bëjnë me fatura të vjetra të trashëguara madje edhe nga viti 2016.</p>
---------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.